

VLORA INTERNATIONAL AIRPORT – VIA SH.P.K.

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin
e mbyllur më 31 dhjetor 2023

VLORA INTERNATIONAL AIRPORT – VIA SH.P.K.

PASQYRAT FINANCIARE

<i>Raporti i auditorit të pavarur</i>	<i>i - iii</i>
<i>Pasqyrat Financiare</i>	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e lëvizjes në kapital	3
Pasqyra e flukseve të parasë	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5 – 30

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Drejtimit e Ortakëve të Shoqërisë Vlora International Airport – VIA sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Vlora International Airport – VIA sh.p.k. ("Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese së bashku me një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin drejt, në të gjithë aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2023, si dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësia jonë sipas këtyre standardeve është përshkruar në paragrafin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të shprehur në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë audituar nga një tjetër auditor i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj sipas parimit të vijueshmërisë, për paraqitjet në shënimet shpjeguese, sipas rastit, çështje të lidhura me vijueshmërinë dhe të përdorë parimin e vijueshmërisë në politikat kontabël, përveçse kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë Shoqërinë ose të ndërpresë veprimtarinë, ose nuk ka alternative tjetër realiste për të vazhduar aktivitetin.

Personat e ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, në tërësi, janë pa anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të lëshuar një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra bashkë, në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të cilat merren bazuar mbi këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim tonë profesional dhe ushtrojmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim, përvetësim të qëllimshëm, keq-interpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim njohuri mbi kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartonjmë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.




- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit nga Drejtimi të parimit të vijimësisë dhe, bazuar në evidencat e marra të auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të ushtruar aktivitetin në vazhdimësi, na kërkohet të tërheqim vëmendjen tek raporti ynë i auditimit duke iu referuar shënimit shpjegues përkatës në pasqyrat financiare për dhënien e informacioneve shpjeguese, ose nëse këto shpjegime nuk janë të mjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të pushojnë së vazhduari aktivitetin në vijimësi.

Ne komunikojmë me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndër të tjera, objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme të auditimit duke përfshirë edhe çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Moore Albania sh.p.k

28 qershor 2024


Desara Liko
Auditues Ligjor


Moore Albania sh.p.k
NUIS M31904014L
Rr. Tish Daija, Kika 2, P. 7, Kati 5, Tiranë, Shqipëri

VLORA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2023

(Vlerat në LEK)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	6	23,982,360	28,747,807
Aktive afatgjatë jo-materiale	7	1,881,796,172	862,835,507
Totali i aktiveve afatgjatë		1,905,778,553	891,583,314
Aktivët afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme e të tjera	8	329,204,758	124,322,221
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	26,059,960	15,133,076
Mjetet monetare në arkë e në bankë	10	1,029,885,538	215,529,964
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,385,150,255	354,985,261
TOTALI I AKTIVEVE		3,290,928,788	1,246,568,575
KAPITALI			
Kapitali themeltar	11	1,228,000	1,228,000
Diferenca nga këmbimi		6,797,041	1,423,475
Fitim (Humbje) të mbartura		13,646,861	(7,809,677)
Fitimi i ushtrimit		42,575,904	21,456,538
TOTALI I KAPITALIT		64,247,806	16,298,336
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua bankare afatgjatë	12	1,038,800,000	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	13	840,389,200	571,150,001
Totali i detyrimeve afatgjatë		1,879,189,200	571,150,001
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	14	1,342,778,434	655,084,492
Tatim mbi fitimin	17	4,022,649	3,509,031
Të pagueshme të tjera		690,698	526,715
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,347,491,782	659,120,238
TOTALI I DETYRIMEVE		3,226,680,982	1,230,270,239
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		3,290,928,788	1,246,568,575

Pasqyrat Financiare të shoqërisë Vlora International Airport – VIA sh.p.k. janë rishikuar nga Asambleja e Ortakëve dhe janë miratuar më 26 qershor 2024.

Valon Lluka

Administrator Vlora International Airport

Ejvan Petemihaj

Pergatitur nga :

Shënimet shpjeguese nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

VLORA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023

(Vlerat në LEK)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura		-	-
Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit të infrastrukturës së koncesionit (IFRIC 12)			
Shërbime ndërtimi të infrastrukturës	15	1,154,003,833	613,938,096
Kosto ndërtimi të infrastrukturës		(1,040,225,825)	(557,392,740)
Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit		113,778,008	56,545,356
Shpenzime administrative	16	(80,685,756)	(31,533,506)
Shpenzime financiare, neto		17,128,624)	(270,244)
Totali i shpenzimeve		(63,557,132)	(31,803,750)
Fitimi (humbja) para tatimit		50,220,876	24,741,606
Tatimi mbi fitimin	17	(7,644,972)	(3,285,068)
Fitimi neto për vitin		42,575,904	21,456,538
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:		42,575,904	1,443,868
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese		6,797,041	1,443,868
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse, neto nga taksa		49,372,945	22,900,406

Shënimet shpjeguese nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

VËLURA INTERNACIONAL AIRPORT SH.P.K.
PASQYRA E LEVIZJES NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023
(Merat në LEK)

	Kapitali i nënshkruar i papaguar	Diferenca nga Konvertimi	Fitim (Humbje) e mbartur	Fitim (humbja) e periudhës	Totali
Gjendja më 31 dhejtor 2021	1,228,000	(20,393)	-	(7,809,677)	(6,602,070)
Transferim në fitime (humbje) të mbartura	-	-	(7,809,677)	7,809,677	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për periudhën	-	1,443,868	-	21,456,538	22,900,406
Gjendja më 31 dhjetor 2022	1,228,000	1,423,475	(7,809,677)	21,456,538	16,298,336
Transferim në fitime (humbje) të mbartura	-	-	21,456,538	(21,456,538)	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	5,373,566	-	42,575,904	47,949,470
Gjendja më 31 dhjetor 2023	1,228,000	6,797,041	13,646,861	42,575,904	64,247,806

Shënimet shpjeguese nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

VLORA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023

(Vlerat në LEK)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	50,220,876	24,741,606
<i>rregullime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	5,228,592	845,401
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Rënie (ritje) në inventar	-	319,410
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(204,718,554)	(117,961,310)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera	687,693,943	655,086,384
Rritje në parapagime e shpenzime të shtyra	(10,926,884)	(4,370,222)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	527,497,973	558,661,269
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(7,131,354)	-
Flukse operative neto	520,366,619	558,661,269
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(1,019,423,811)	(752,556,534)
Mjete monetare të përdorura për aktivitet investues	(1,019,423,811)	(752,556,534)
Aktivitetet financuese		
Të hyra neto nga huatë afatgjata	1,038,800,000	-
Financime të ortakëve	269,239,199	(32,649,908)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	1,308,039,199	(32,649,908)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	808,982,007	(226,545,173)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	215,529,964	440,407,306
Efekti i këmbimit valutor	5,373,566	1,667,831
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,029,885,538	215,529,964
10		

Shënimet shpjeguese nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.